Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*
*Ministarstvo Kulture, Omladina i Sporta - Ministry of Culture, Youth & Sport*
Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Minister's Office

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria e Kosovës · Vlada Kosova · Government of Kosova
Ref.Nr. 746 / 2012
Data 30-03 2012
PRISHTINË, PRIŠTINA, PRISHTINA

Bazuar në Nenin 145 pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh Nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, Nenin 8, paragrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Rregullores për Çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" dhe Çmimet Vjetore për Letërsi, Raportit me numër 722/2012, të datës 27.03.2012 të Jurisë Vlerësuese, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit z. Memli Krasniqi, më datën 30 mars 2012, mori këtë:

VENDIM
Për Çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli"

1. Çmimi Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" për vitin 2011 i ndahet poetit, prozatorit dhe dramaturgut Musa Ramadani.

2. Çmimi shoqërohet me Certifikatë, Mirënjohje dhe shpërblim në vlerë prej 5,000,00 €, e cila paguhet në llogarinë e tij rrjedhëse.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

*Arsyetim*

Musa Ramadani me krijimtarinë e vet ka ndikuar në avancimin e kulturës së shkrimit dhe zhvillimin e formave të reja shprehëse që u qëndrojnë pranë veprave të mëdha të letërsisë evropiane. Po ashtu Ramadani me veprën e tij shumëdimensionale e përmbushi misionin e krijuesit të përkushtuar, që nëpërmjet artit ta kultivojë dhe afirmojë botën e etnisë në përmasa qytetëruese, njerëzore.

*I dërgohet:*

- *Kabinetit të Ministrit*
- *Zyrës së Sekretarit*
- *Palës*
- *Dpt Kulturës*
- *Zyrës së financave*
- *Arkivit të MKRS*

Memli Krasniqi
Ministër